

VENDIM
Nr. 800, datë 29.12.2017

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE
PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE NDËRMARRJES SË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE,
KORÇË, SI AGJENCI
E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN
E PROJEKTIT “KANALIZIMET E UJËRAVE TË ZEZA KORÇË, III”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Ndërmarrjes së Ujësjiellës-Kanalizimeve, Korçë, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Kanalizimet e ujërave të zeza Korçë, III”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KfW Bankengruppe, Postfach Fusha e biznesit
111141, 60046 Frankfurt am Main KfW Entwicklungsbank

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Ministër Arben Ahmetaj
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
nr. 1
Tiranë, Shqipëri
Jan Kleinheisterkamp
Ref. jonë: Khtk/Tch
Tel.: +49 86 7431-2594
Faks: +49 86 7431-2547
Jan.kleinheisterkamp@kfw.de

Në vëmendje të:
KfW- Zyra Tiranë
Z. Bledar Dollaku,
Koordinator i projektit
Tiranë, Shqipëri
Datë 10.11.2016

LEa/4 - Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Përdorimi i fondeve të mbetura të projektit “Kanalizimet e ujërave të zeza, Korçë III” (BMZ-ID 2003 66 609) për shlyerje huash

I nderuar ministër Ahmetaj,

Projekti “Kanalizimet e ujërave të zeza, Korçë III” ka përfunduar në vitin 2012. Projekti është financuar nga një grant nga BMZ-ja, në shumën 5 milionë euro, nga të cilat 168,028.17 euro nuk janë përdorur dhe janë fonde të mbetura. Marrëveshja përkatëse e financimit dhe e projektit është nënshkruar

më 3 maj 2005.

Është e qartë tashmë që për fazën tjetër “Kanalizimet e ujërave të zeza, Korçë IV” nuk janë të nevojshme fonde shtesë. Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, ka mundësinë për të përdorur fondet e mbetura për shlyerjen e një huaje të KfW-së, mundësisht në të njëjtin sektor.

Ju lutem, na informoni nëse do të zgjidhni përdorimin e fondeve të mbetura për shlyerjen e një huaje të KfW-së, duke nënshkruar më poshtë.

Me respekt,

Dr. Kirk Mildner

Përgjegjës sektori

Jan Kleinheisterkamp

Menaxher i projektit

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, 30.12.2016

Nënshkrimi: _____

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë:

Emri: Arben Ahmetaj

Pozicioni: Ministër i Financave